



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD

Numri i lëndës: 2022:119553

Datë: 04.04.2024

Numri i dokumentit: 05547122

CPK.nr.02/24
P.nr. 134/2015
E.nr.1053/09

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Dega Novobërdë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, përmes gjyqtarit G. A, duke vendosur në procedurën përmbarimore të kreditorit N. K, nga fshati K, Komuna e Prishtinës, të cilin e përfaqëson av. N. U nga P., rruga “N.T “nr. 24/4, ndaj debitorëve S. R “Rr. e P.” pa nr. dhe B. R lagjia “Z.i S. A” nr.47, rruga “V. I”, të dy nga Gj. duke vendosur lidhur me prapësimin e personave të tretë F. R “Rr. e P.” prapa restaurant G. , R.D “Rr. e P, E. M “R.e P” prapa restaurant G. , R. S “Rr. e P.”, prapa restaurant G., N. Sh “Rr. e P.”, prapa restaurant G., A. S “Rr. e P”, prapa restaurant G., Sh. Sh “Rr. e P”, prapa restaurant G. dhe I.R “Rr. e P”, prapa restaurant G. të gjithë nga Gj. jashtë seancës gjyqësore me datën 04.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET i pa bazuar prapësimi personave të tretë R.S, N.Sh, A.S, Sh.Sh i datës 19.11.2012, pastaj prapësimi F.R, R.D dhe E .M i datës 30.11.2012 dhe i I.R i datës 28.12.2012, i paraqitur kundër Aktvendimit për përmbarim të ish Gjykatës Komunale në Gjilan E.nr.1053/2009 i datës 03.11.2009.

II. Mbetet në fuqi Aktvendimi për përmbarim i ish Gjykatës Komunale në Gjilan E.nr.1053/2009 i datës 03.11.2009, lëshuar nga ish Gjykata Komunale në Gjilan.

A r s y e t i m i

Ish Gjykata Komunale në Gjilan, me Aktvendimin për përmbarim E.nr.1053/2009 të datës 03.11.2009, ka lejuar Përmbarimin të propozuar nga kreditori N. K, nga fshati K, Komuna e P. ndaj debitorëve: S. R dhe B.R të dy nga Gj., që në afatin prej shtatë ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, të përmbush borxhin në shumë prej 160.000 DM, të konvertuara në euro, në bazë të aktgjykimit të Plotfuqishëm të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P.nr.622/2004 të datës 12.03.2007, me kamatë vjetore bankare, me mjetet të afatizuara duke llogaritur nga data

17.04.2001, e deri në pagesën definitive si dhe të i paguajnë shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Ndaj këtij Aktvendimi Përmbartimor E.nr.1053/2009 të datës 03.11.2009, personat e tretë F. R, R. D, E.M me datën 30.11.2012, R.S, N. Sh, A.S, Sh.Sh me datën 19.11.2012 dhe I. R nga Gj. me datat me datën 28.12.2012, kanë ushtruar prapësim, për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vërtetimit të gabuar të së drejtës materiale. Të njëjtit kanë theksuar se ngastrat kadastrale nr.3761/1,3761/2,3761/4 në vendin e quajtur “K...” ZK. K. i kanë blerë menjëherë pas luftës, përkatësisht në vitin 2000. Më tutje kanë shtuar se sipas informacioneve që ju kanë ofruar shitësit e mëparshëm, ngastra kadastrale nr.3761 në vendin e quajtur “K...” ZK. K, ka qenë objekt i një shqyrtimi gjyqësor në Prishtinë, mirëpo që transaksioni ka qenë në rregull, në fjalën përfundimtare të prokurorit sipas lëndës PP.nr.294/04 të datës 07 Mars 2007 është konstatuar se shitblerja ka qenë në rregull dhe ka hequr dorë për këtë. Përndryshe në ngastrat kad.nr.3761/5,6,7,8,9 dhe 10, në këto ngastra janë të ndërtuar shtëpi dhe të njëjtat rrugë tjetër nuk kanë.

Kreditori përmes të autorizuarit të tij në afatin e paraparë ligjor me datën 01.12.2012 ka ushtruar përgjigje në prapësim, duke theksuar se ky prapësim është i pabazë dhe i propozon gjykatës që të njëjtin ta refuzoj si të pabazuar në ligj. Kjo për faktin që gjykata me Aktvendimin e saj E.nr.270/05 të datës 20.05.2005, e ka aprovuar masën e përkohshme dhe e ka ndaluar shitblerjen dhe vërtetimin e kontratave të shitblerjeve të ngastrave kadastrale të theksuara në pronësi të debitorit B.B. Pra këto paluajtshmëri nuk mund të shiten e as që kontratat të vërtetohen dhe prona të regjistrohet në librat e Zyrës Komonale Kadastrale. Kreditori po ashtu thekson që konstatimi në prapësim i personave të tretë për kinse ekzistimin e kontratave të shitblerjes të vërtetuara në ish Gjykatën Komonale në Gjilan për paluajtshmëritë e theksuara, të cilat kinse janë theksuar në rastin penal është po ashtu i paqëndrueshëm dhe i pabazë ngase gjykata dhe drejtoria kadastrale kanë zbatuar masën e përkohshme të ndalimi të vërtetimit të kontratave të shitblerjes dhe regjistrimit të paluajtshmërive në personave të tretë dhe se në aktgjykimet e formës së prerë të theksuara të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, mbi bazën e të cilit është lejuar ekzekutimi nuk ekziston kurrfarë përjashtimi për shitjen e paluajtshmërive, të përmendura të debitorit B.R për kompensimin e kreditorit.

Gjykata pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, konstatoi se prapësimi i personave të tretë R. S, N. Sh, A.S, Sh.Sh i datës 19.11.2012, pastaj prapësimi F. R, R. D dhe E. M është i pabazuar, pasi që i njëjti nuk ka vërtetuar asnjëherë nga shkaqet të cilat janë paraparë në nenin 71 të LPP-së, lidhur me bazueshmërinë e prapësimeve dhe se Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë,

P.nr.622/2004 i datës 12.03.2007 dhe i formës së prerë më datën 09.09.2009 dhe i ekzekutueshëm, me të cilën është lejuar përmbartimi, paraqet titull përmbartimor, duke u bazuar në nenin 22 para 1 pika 1.1 të LPP-së.

Nga të cekurat më lartë e në pajtim me nenin 5, 22, 71, 72, 73,75 dhe 76 të LPP-së u vendos si në pikën I dhe II të këtij aktvendimi.

Gjykata Themelore në Gjilan - Dega Novobërdë
CPK.nr.02/2024, me datën 04.04.2024

Numri i lëndës: 2022:119553
Datë: 04.04.2024
Numri i dokumentit: 05547122

**Gjyqtari,
G.A**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, brenda 7 ditësh nga dita e pranimin të këtij aktvendimi. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj gjykate.